

Ligji 40/2018 date 09.07.2018

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN
E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislationit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si “agroturizëm””.

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

Miratuar në datën 9.7.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10843, datë 26.7.2018 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

Botuar ne F.Zyrtare 111/2018

Dale nga shtypi me 30.07.2018